

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission in
Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies
au Kosovo

UNMIK/REG/2005/32
21 qershor 2005

RREGULLORE NR. 2005/32

MBI KODIN E AKCIZËS SË KOSOVËS

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999 mbi Autorizimin e Administratës së Përkohshme në Kosovë dhe Rregulloren nr. 2004/1 të UNMIK-ut të datës 30 janar 2004 mbi Kodin doganor të Kosovës,

Në pajtim me Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Pas konsultimit me Qeverinë dhe Këshillin ekonomik dhe fiskal,

Me qëllim të themelimit të një sistemi gjithëpërfshirës dhe efikas për kontrollimin dhe arkëtimin e akcizës në Kosovë,

Me anë të kësaj shpall sa vijon:

PËRMBAJTJA

KAPITULLI 1.....	4
DISPOZITAT E PËRGJITHSME.....	4
NENI 1	4
PËRSHKRIMI	4
NENI 2	4
INTERPRETIMI.....	4
NENI 3	7
KONTROLI DHE MENAXHIMI	7
KAPITULLI 2.....	8
TATIMI I PRODUKTEVE ME AKCIZË	8
NENI 4	8
CAKTIMI I AKCIZËS	8
NENI 5	8
PËRJASHTIMET	8
NENI 6	9
KTHIMI I PARAVE DHE SHLYERJA.....	9
NENI 7	9
BARTJA E PRODUKTEVE ME AKCIZË	9
NENI 8	10
SHMANGIA	10
NENI 9	11
PULLAT FISKALE.....	11
NENI 10	12
PAGESA E AKCIZËS	12
KTHIMI I TAKSËS	13
KAPITULLI 3.....	14
AUTORIZIMET DHE MIRATIMET.....	14
NENI 12	14
DEPOT E AUTORIZUARA PËR MALLRAT ME AKCIZË	14
NENI 13	14
DEPOISTI I AUTORIZUAR PËR MALLRAT ME AKCIZË	14
NENI 14	16
TREGTARI I AUTORIZUAR PËR MALLRAT ME AKCIZË	16
NENI 15	17
MIRATIMI I REGJISTRAVE.....	17
NENI 16	18
REFUZIMI, REVOKIMI DHE PEZULLIMI I AUTORIZIMEVE DHE MIRATIMEVE.....	18
KAPITULLI 4.....	19
KOMPETENCAT	19
NENI 17	19
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME	19
NENI 18	19
KOMPETENCA PËR TA KËRKUAR PARAQITJEN E REGJISTRAVE TË MIRATUAR	19
NENI 19	20
KOMPETENCA PËR TË HYRË DHE PËR TË KONTROLLUAR DEPON E AUTORIZUAR PËR MALLRA ME AKCIZË	20
NENI 20	20
KOMPETENCA PËR TA SIGURUAR URDRHRIN PËR KONTROLLIMIN E LOKALEVE.....	20
NENI 21	22

KOMPETENCAT PËR TË MARRË MOSTRA	22
NENI 22	23
KOMPETENCA PËR TË HYRË NË TOKËN PËR TË PASUR QASJE NË TUBACIONET APO LIDHUR ME TO	23
NENI 23	23
KOMPETENCA PËR TË GJURMUAR PËR TUBACIONE TË FSHEHURA	23
NENI 24	24
KOMPETENCA PËR TË KONTROLLUAR AUTOMJETET	24
NENI 25	24
KOMPETENCAT PËR TË KONTROLLUAR PERSONA.....	24
KAPITULLI 5.....	25
SHKELJET ADMINISTRATIVE DHE PENALE	25
NENI 26	25
SHKELJET ADMINISTRATIVE	25
NENI 27	26
SHKELJET PENALE	26
NENI 28	26
ZBATIMI I KODIT TË PËRKOSSHËM PENAL TË KOSOVËS.....	26
KAPITULLI 6.....	26
NDALIMI DHE KONFISKIMI.....	26
NENI 29	26
NDALIMI DHE KONFISKIMI I PRODUKTEVE ME AKCIZË	26
KAPITULLI.....	29
ANKESAT.....	29
NENI 30	29
ANKESAT.....	29
KAPITULLI 8.....	31
SHFUQIZIMET, LIGJI NË FUQI DHE HYRJA NË FUQI	31
NENI 31	31
SHFUQIZIMET	31
NENI 32	31
ZBATIMI	31
NENI 33	31
LIGJI NË FUQI.....	31
NENI 34	31
HYRJA NË FUQI	31
SHTOJCA A	32
MALLRAT QË I NËNSHTROHEN AKCIZAVE DHE TARIFAT PËRKATËSE.....	32
SHTOJCA B.....	35
PRODUKTET E LIRUARA NGA AKCIZA	35
SHTOJCA C	36
ORGANIZATAT DHE SUBJEKTET TJERA QË NUK PAGUAJNË AKCIZË	36
SHTOJCA D	37
SHFUQIZIMET.....	37

KAPITULLI 1 DISPOZITAT E PËRGJITHSME

Neni 1 Përshkrimi

Akciza është taksë e cila u ngarkohet produkteve me akcizë të lëshuar në qarkullim në Kosovë.

Neni 2 Interpretimi

2.1 Në këtë Rregullore:

(a) “Regjistra të miratuar” janë regjistrat e miratuar nga drejtori i përgjithshëm në bazë të nenit 15,

(b) “Tregtar i autorizuar i mallrave me akcizë” është ndonjë person fizik a juridik i autorizuar nga drejtori i përgjithshëm sipas nenit 14 për të pranuar produkte me akcizë, nëse akciza është pezulluar në bazë të marrëveshjes për pezullim në mënyrë që ai të mund t’i shfrytëzojë këto produkte me akcizë gjatë veprimtarisë së tij afariste,

(c) “Depo e autorizuar e mallrave me akcizë” është objekti i autorizuar nga drejtori i përgjithshëm në bazë të nenit 12 në të cilin në bazë të marrëveshjes për pezullim mund të prodhohen, të përpunohen, të ruhen, të pranohen ose të dërgohen mallrat me akcizë nga ana e ndonjë depoisti të autorizuar të mallrave me akcizë, në përputhje me kushtet të cilat mund t’i përcaktojë drejtori i përgjithshëm,

(d) “Depoist i autorizuar i mallrave me akcizë” është ndonjë person fizik a juridik i autorizuar nga drejtori i përgjithshëm sipas nenit 13 për të prodhuar, përpunuar, ruajtur, pranuar ose dërguar produktet me akcizë në ndonjë depo të autorizuar të mallrave me akcizë nëse akciza është pezulluar në bazë të marrëveshjes për pezullim në përputhje me kushtet të cilat mund t’i përcaktojë drejtori i përgjithshëm,

(e) “Banderolë” është një lloj i pullës fiskale që duhet ngjitur në produktin me akcizë e cila është paraparë të çahet gjatë hapjes së tij,

(f) “Drejtor i përgjithshëm” është drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Doganor të UNMIK-ut,

(g) “Produkt me akcizë” është çdo produkt që i nënshtrohet akcizës,

(h) “Eksport” dhe “eksportim” është bartja ose dërgimi i ndonjë produkti me akcizë prej Kosovës në ndonjë shtet, rajon ose vend jashtë Kosove. Këto shprehje zbatohen në përputhje me nenin 2.1 (k),

(i) “Pullë fiskale” është pulla e cila sipas nenit 9 kërkohet që ta ketë secili produkt me akcizë e cila mund të theksojë të gjitha ose ndonjë prej të mëposhtmeve:

- (i) se është paguar akciza për produktin,
- (ii) tarifën e akcizës që është paguar për produktin,
- (iii) shumën e paguar të akcizës për produktin,
- (iv) kur është paguar akciza për produktin dhe
- (v) se shitja e produktit:
 - është e lejuar vetëm në datën e theksuar në pullë,
 - nuk është e lejuar pas asaj date, në apo pas datës së theksuar në pullë dhe
 - nuk është e lejuar para asaj date në apo para datës së theksuar në pullë,

(j) “Import” dhe “importim” është bartja ose dërgimi i ndonjë produkti me akcizë prej ndonjë shteti, rajoni ose vendi jashtë Kosovë për në Kosovë. Këto shprehje zbatohen në përputhje me nenin 2.1 (k),

(k) “Kosovë” është territori sipas përkufizimit në Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara,

(l) “Bordi i pavarur për rishqyrtim” është Brodi i themeluar fillimisht me anë të Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2000/7 të datës 12 prill 2000 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/20 të datës 12 prill 2000 mbi Administratën dhe procedurat tatimore, që tani rregullohet me anë të Ligjit për administratën dhe procedurat tatimore të shpallur me anë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/17 të datës 9 prill 2005.

(m) “Lëshim në qarkullim” përkitazi me produktet me akcizë do të thotë:

- (i) largimi i tyre prej marrëveshjes për pezullim duke e përfshirë largimin e kundërligjshëm.
- (ii) prodhimin e tyre jashtë marrëveshjes për pezullim, duke e përfshirë prodhimin e kundërligjshëm.
- (iii) importimin e tyre nëse ai produkt nuk është në kuadër të marrëveshjes për pezullim duke e përfshirë importimin e kundërligjshëm. ,

(iv) nëse produkti me akcizë është përjashtuar prej akcizës në bazë të nenit 5.1 dhe se produkti nuk përdoret për qëllimin për të cilin është përjashtuar,

(v) nëse akciza nuk paguhet nga ndonjë trup, organ, agjenci ose ndonjë organizatë tjetër në bazë të nenit 5.2 dhe se produkti me akcizë nuk përdoret për qëllimin për të cilin është përjashtuar nga pagesa dhe

(vi) nëse zbulohet mungesë sasive e cila i nënshtrohet akcizës në bazë të neneve 7.7, 13.6 dhe 14.6.

(n) “Kthim i parave” është refondimi i plotë ose i pjesërishtëm i akcizës së paguar,

(o) “Shlyerje” është vendimi për të hequr krejt ose një pjesë të ndonjë shume të akcizës e cila duhet të paguhet ose vendimi për ta shpallur të pavlefshëm ndonjë deklaram në libra të krejt ose një pjesë të ndonjë shume të akcizës e cila nuk është paguar,

(p) “Zyrtar” është ndonjë zyrtar i Shërbimit Doganor të UNMIK-ut,

(q) “Garantim i mjaftueshëm” është garanca e pranueshme për drejtorin e përgjithshëm për qëllimin për të cilin ofrohet ajo,

(r) “Marrëveshje pezullimi” është marrëveshja tatimore e cila zbatohet për importin, eksportin, prodhimin, përpunimin, ruajtjen dhe bartjen e produkteve me akcizë me anë të së cilës pezullohet kërkesa për të paguar akcizën;

(s) “Produkt i duhanit” është cilado prej të mëposhtmeve:

(i) cigare,

(ii) puro dhe cigarillosët

(iii) prodhimet e tjera të përpunuara të duhanit,

të cilat janë përpunuar në tërësi ose pjesërisht prej duhanit apo ndonjë substance që përdoret si zëvendësim i duhanit, por që nuk i përfshin produktet bimore për tymosje dhe

(t) “Orari i punës” është cilado kohë në mes të orës 09.00 dhe 17.00 çdo të hënë, të martë, të mërkurë, të enjte dhe të premte, përveç kur ajo ditë është festë publike.

2.2 Në këtë Rregullore, përveç rasteve kur konteksti e kërkon ndryshe:

(a) njëjësi e përfshin shumësin dhe shumësi e përfshin njëjësin dhe

(b) “ai” e përfshin “ajo” dhe “atij” e përfshin “asaj”.

2.3 Në këtë Rregullore, përveç rasteve kur konteksti e kërkon ndryshe, referencat në kapituj, nene dhe paragrafe janë referenca të këtyre pjesëve në këtë Rregullore.

Neni 3 Kontrolli dhe menaxhimi

3.1 Akciza kontrollohet dhe menaxhohet nga Shërbimi Doganor i UNMIK-ut. Të gjitha taksat e akcizës të arkëtuara nga Shërbimi Doganor i UNMIKut depozitohen në Fondin e Konsoliduar të Kosovës.

3.2 Në rastet kur në këtë Rregullore ose në bazë të saj, drejtori i përgjithshëm e ka për detyrë ose është në kompetencën e tij të ndërmarrë ndonjë veprim, këtë detyrë a kompetencë ai mund t'ia delegojë ndonjë personi të caktuar ose ndonjë nivel të caktuar të zyrtarit ndonjë nivel të caktuar të zyrtarit në ndonjë vend të caktuar dhe këtë delegim e regjistron në një instrument me shkrim dhe:

(a) një kopje të këtij instrumenti të delegimit e len në dispozicion për inspektim publik në selinë e Shërbimit Doganor të UNMIK-ut dhe

(b) një kopje tjetër e mban në dispozicion për inspektim publik në mënyrë elektronike.

KAPITULLI 2 TATIMI I PRODUKTEVE ME AKCIZË

Neni 4 Caktimi i akcizës

4.1 Secilit produkt me akcizë i caktohet akciza në tarifën e cila vlen për të në datën dhe kohën kur produkti lëshohet në qarkullim në Kosovë.

4.2 Kur caktohet akciza për produktin me akcizë i cili lëshohet në qarkullim nëpërmjet largimit, prodhimit apo importimit të kundërligjshëm, akciza duhet të paguhet menjëherë për atë produkt me akcizë dhe deri sa ajo të paguhet produkti i nënshtrohet ndalimit dhe konfiskimit.

4.3 Në qoftë se në kohën e lëshimit në qarkullim të ndonjë produkti me akcizë tashmë është paguar një shumë e akcizës përkitazi me atë produkt për ndonjë pullë fiskale ose banderolë të ngjitur në të, akciza caktohet vetëm atëherë sa është dallimi në mes të tarifës e cila vlen në kohën e lëshimit në qarkullim dhe shumës së paguar për pullën fiskale ose banderolën.

4.4 Kur caktohet akciza për importimin e ndonjë produkti me akcizë në bazë të vlerës së produktit, duke përfshirë importimin e kundërligjshëm të tij, ajo caktohet në bazë të vlerës së produktit për qëllime të importimit, bashkë me ndonjë obligim doganor që duhet të paguhet për importimin e atij produkti, por duke e përjashtuar tatimin në vlerën e shtuar që duhet të paguhet për importimin e këtij produkti.

4.5 Tarifat e tanishme të akcizës si dhe produktet që i nënshtrohen akcizës janë përcaktuar në shtojcën A të kësaj Rregulloreje.

Neni 5 Përjashtimet

5.1 Produktet me akcizë të përcaktuara në shtojcën B të kësaj Rregulloreje përjashtohen prej akcizës.

5.2 Akcizën nuk e paguajnë trupat, organet, agjencitë dhe organizatat tjera të përcaktuara në shtojcën C të kësaj Rregulloreje.

5.3 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm me anë të ndonjë urdhërese administrative mund t'i ndryshojë shtojcat B dhe C dhe, në raste të posaçme mund ta përjashtojë ndonjë produkt tjetër prej akcizës apo ta përjashtojë ndonjë trup, organ, agjenci apo organizatë tjetër prej pagesës së akcizës nëse këtë e konsideron të përshtatshme.

Neni 6
Kthimi i parave dhe shlyerja

6.1 Varësisht prej kufizimeve të cilat mund t'i caktojë ai, nëse drejtori i përgjithshëm vlerëson se ndonjë produkt me akcizë për të cilin është paguar akciza është përdorur për qëllime tjera nga ato për të cilat i ngarkohet akciza, apo nëse ndonjë produkt me akcizë për të cilin është paguar akciza është shkatërruar nën mbikëqyrjen e doganës ose është eksportuar me kërkesë të personit i cili e ka paguar akcizën, ai mundet që në çdo do kohë, deri në 1 vit prej datës kur është paguar taksa, t'ia kthejë atij personi shumën e paguar të akcizës.

6.2 Akciza nuk duhet të paguhet përkitazi me ndonjë produkt në kuadër të marrëveshjes për pezullim i cili është shkatërruar nën mbikëqyrjen e Shërbimit Doganor të Kosovës.

Neni 7
Bartja e produkteve me akcizë

7.1 Bartja e produkteve me akcizë në kuadër të marrëveshjes për pezullim lejohet vetëm:

(a) në mes të ndonjë depoje të autorizuar të mallrave me akcizë dhe një depoje tjetër të autorizuar të mallrave me akcizë ose ndonjë tregtari të autorizuar të mallrave me akcizë,

(b) gjatë importit të drejtpërdrejtë të tyre deri te ndonjë depo e autorizuar e mallrave me akcizë ose te ndonjë tregtar i autorizuar i mallrave me akcizë dhe

(c) gjatë eksportit të drejtpërdrejtë të tyre prej ndonjë depoje të autorizuar të mallrave me akcizë.

7.2 Përveç asaj siç është paraparë me nenin 7.3, të gjitha bartjet e produkteve me akcizë:

(a) në bazë të nenit 7.1(a) dhe 7.1(c) duhet të mbulohen me garacion të mjaftueshëm të siguruar nga depoisti i autorizuar i mallrave me akcizë për dërgimin dhe

(b) në bazë të nenit 7.1(b) duhet të mbulohen me garacion të mjaftueshëm të siguruar nga depoisti ose tregtari i autorizuar i mallrave me akcizë për pranimin.

7.3 Drejtori i përgjithshëm, kur e vlerëson të përshtatshme, mund ta heqë kërkesën për garacion të mjaftueshëm në bazë të nenit 7.2 ose si alternativë të kërkesave të atij neni:

(a) në rastet kur nuk kërkohet në bazë të nenit 7.2(b), kërkon nga marrësi i dërgesës që të sigurojë garancionin e mjaftueshëm për ta mbuluar bartjen e ndonjë produkti me akcizë dhe

(b) lejon;

(i) garancionin e mjaftueshëm që i obligon bashkë ose veçmas marrësin e dërgesës dhe transportuesin për të mbuluar bartjen e ndonjë produkti me akcizë dhe

(ii) transportuesin ose pronarin e produkteve që të sigurojë garancionin e mjaftueshëm për të mbuluar bartjen e ndonjë produkti me akcizë.

7.4 Përgjegjësia e personit i cili e siguron garancionin përmbushet vetëm me anë të dëshmisë se marrësi e ka marrë dërgesën e mallrave me akcizë ose se ato janë eksportuar.

7.5 Drejtori i përgjithshëm, pas konsultimit me Qeverinë, me një udhëzim administrative i përcakton kushtet në bazë të të cilave duhet të bëhet bartja e ndonjë produkti me akcizë dhe dokumentet të cilat duhet të shoqërojnë bartjen.

7.6 Nëse produkti me akcizë ka humbur ose është shkatërruar si rezultat i ndonjë aksidenti ose force madhore, ose kur ndodh humbja si pasojë e bartjes së ndonjë produkti të caktuar me akcizë, personi i cili e siguron garancionin në lidhje me atë produkt e njofton menjëherë drejtorin e përgjithshëm lidhur me humbjen ose shkatërrimin.

7.7 Nëse drejtori i përgjithshëm vlerëson se humbja e produkteve me akcizë gjatë bartjes së mbuluar me garancion të siguruar sipas këtij neni nuk është shkaktuar nga ndonjë aksident a forcë madhore ose nuk ka qenë humbje si pasojë e natyrës së produkteve me akcizë të cilat janë bartur, akciza konsiderohet se mund të caktohet në produktet e humbura sipas tarifës që do të caktohej në datën e humbjes apo në datën e zbulimit të humbjes nëse kjo nuk mund të vërtetohet dhe duhet të paguhet nga personi i cili e siguron garancionin.

Neni 8 Shmangia

8.1 “Urdhri në bazë të këtij neni” është urdhër i drejtorit të përgjithshëm që personi i emërtuar në urdhër nuk duhet:

(a) të importojë ndonjë produkt me akcizë të emërtuar në urdhër dhe

(b) të largojë nga marrëveshja për pezullim ndonjë produkt me akcizë të emërtuar në urdhër;

nëse importimi ose largimi do të tejkalonin shumën mesatare të importuar ose të larguar nga ai person gjatë 9 muajve paraprak (e cila do të jetë zero në rastin e personit i cili kurrë më parë nuk ka importuar, larguar ose kërkuar).

8.2 Nëse drejtori i përgjithshëm beson se personi e propozon importin e ndonjë produkti me akcizë ose largimin e ndonjë produkti me akcizë nga marrëveshja për pezullim me qëllim që t'i shmangët rritjes së ardhshme të mundshme të tarifës së akcizës për atë produkt, ai mund ta nxjerrë urdhrin në bazë të këtij neni.

8.3 Urdhri në bazë të këtij neni i komunikohet me shkrim personit në fjalë:

(a) duke ia dorëzuar apo duke ia lënë ose duke dërguar me postë në adresën e tij të fundit të ditur të biznesit apo shtëpisë ose

(b) nëse personi e ka adresën elektronike, i dërgohet në atë adresë elektronike.

8.4 Nxjerrja e urdhrin në bazë të këtij neni është çështje për të cilën mund të parashtrohet ankesë në Bordin e pavarur për rishqyrtim.

Neni 9 Pullat fiskale

9.1 Nëse produkti me akcizë kërkohet ta ketë pullën fiskale, drejtori i përgjithshëm, pas konsultimit me Qeverinë, me anë të një udhëzimi administrativ e përcakton:

(a) përmbajtjen e pullës;

(b) dukjen e pullës;

(c) vendin në paketimin e produktit me akcizë ku duhet vendosur pulla fiskale dhe

(d) cila(t) shtresa duhet ta kenë pullën nëse produkti me akcizë ka më shumë se një shtresë të paketimit.

9.2 Nëse ndonjë produkt me akcizë duhet të shënohet me shënues kimik në mënyrë që të lirohet prej akcizës, drejtori i përgjithshëm pas konsultimit me Qeverinë me anë të një udhëzimi administrativ e përcakton:

(a) shënuesin kimik që duhet përdorur;

(b) përgjegjësinë për ta ndaluar dhe konfiskuar ndonjë produkt me akcizë të shënuar i cili përdoret për ndonjë qëllim për të cilin nuk është liruar prej akcizës dhe

(c) ndonjë çështje tjetër të cilën drejtori i përgjithshëm e konsideron të nevojshme për të siguruar mbrojtjen e akcizës e cila nuk i nënshtrohet lirimit.

Neni 10
Pagesa e akcizës

10.1 Akciza në import caktohet dhe paguhet sikur të ishte detyrë e doganave.

10.2 Në vartësi të nenit 10.3 dhe 10.4, asnjë produkt i cili nuk dërgohet në një depo tjetër të autorizuar për mallra me akcizë të ndonjë tregtar i autorizuar i mallrave me akcizë ose që nuk eksportohet nuk mund të largohet nga depoja e autorizuar e mallrave me akcizë përveç nëse është paguar akciza që duhet të paguhet për atë produkt nga depoisti i autorizuar i mallrave me akcizë i asaj depoje.

10.3 Nëse drejtori i përgjithshëm vlerëson se akciza e cila duhet të paguhet është e garantuar, ai mund t'i lejojë ndonjë depoisti të autorizuar të mallrave me akcizë që akcizën të cilën duhet ta paguajë në bazë të nenit 10.2 ta paguajë me kiste javore ose mujore.

10.4 Drejtori i përgjithshëm, pas konsultimit me Qeverinë, me anë të udhëzimit administrativ i përcakton formularët të cilët duhet të përdoren nga depoisti i autorizuar i mallrave me akcizë për ta paguar akcizën dhe regjistrat tjerë të cilët duhet të mbahen, si dhe kushtet tjera të cilat mund të zbatohen ndaj depoistit të autorizuar të mallrave me akcizë, i cili e paguan akcizën në bazë të dispozitave të nenit.

10.5 Nëse akciza konsiderohet se duhet të paguhet sipas dispozitave të nenit 7.7, kurse nuk paguhet brenda një muaji prej datës kur është zbuluar humbja, drejtori i përgjithshëm mund ta vlerësojë shumën e akcizës që duhet të paguhet dhe e njofton personin i cili e ka dhënë garancionin për atë shumë dhe kjo shumë konsiderohet si një shumë e akcizës që duhet të paguhet menjëherë nga personi i cili e ka dhënë garancionin, prandaj kërkohet të paguhet nga ai brenda 30 ditëve prej datës së njoftimit.

10.6 Nëse akciza konsiderohet se duhet të paguhet sipas dispozitave të nenit 13.6, kurse nuk paguhet brenda një muaji prej datës kur është zbuluar humbja, drejtori i përgjithshëm mund ta vlerësojë shumën e akcizës që duhet të paguhet dhe e njofton depoistin e autorizuar të mallrave me akcizë për atë shumë dhe kjo shumë konsiderohet si një shumë e akcizës që duhet të paguhet menjëherë nga depoisti i autorizuar i mallrave me akcizë dhe kërkohet të paguhet nga ai brenda 30 ditëve prej datës së njoftimit.

10.7 Nëse akciza konsiderohet se duhet të paguhet sipas dispozitave të nenit 14.6, kurse nuk paguhet brenda një muaji prej datës kur është zbuluar humbja, drejtori i përgjithshëm mund ta vlerësojë shumën e akcizës që duhet të paguhet dhe e njofton tregtarin e autorizuar të mallrave me akcizë për atë shumë dhe kjo shumë konsiderohet si një shumë e akcizës që duhet të paguhet menjëherë nga tregtari i autorizuar i mallrave me akcizë dhe kërkohet të paguhet nga ai brenda 30 ditëve prej datës së njoftimit.

10.8 Kur bëhet vlerësimi në bazë të këtij neni, kamata caktohet sipas tarifës së tregut deri në datën e vlerësimit prej datës së humbjes ose, nëse kjo nuk mund të vërtetohet, prej datës kur mallrat janë futur në marrëveshjen më të fundit për pezullim të cilës i janë nënshtruar.

10.9 Njoftimi për vlerësim:

(a) në bazë të nenit 10.5 konsiderohet se është bërë nëse është dorëzuar ose është lënë në adresën e përcaktuar në garancion të personit, i cili e ka dhënë atë garancion,

(b) në bazë të nenit 10.6 konsiderohet se është bërë nëse është dorëzuar ose është lënë në depon e autorizuar të mallrave me akcizë për të cilën është caktuar depoisti i autorizuar i mallrave me akcizë dhe

(c) në bazë të nenit 10.7 konsiderohet se është bërë nëse është dorëzuar ose është lënë në objektet rreth të cilave tregtari i autorizuar i mallrave me akcizë ka të drejtë që të pranojë mallra me akcizë në bazë të marrëveshjes për pezullim.

NENI 11

Kthimi i taksës

11.1 Nëse ekziston ndonjë borxh për akcizë, duke përfshirë akcizën që konsiderohet se duhet të paguhet, e cila kërkohet të paguhet nga ndonjë deposit i autorizuar i mallrave me akcizë, nga ndonjë tregtar i autorizuar i mallrave me akcizë ose nga ndonjë person që e jep garancionin i cili nuk është paguar deri në datën në të cilën është dashur të paguhet, atëherë drejtori i përgjithshëm, përveç kësaj ose në vend se të kërkojë pagesën sipas garancionit, mund të:

(a) autorizojë ndonjë zyrtar që të hyjë gjatë orarit të punës në ndonjë depo të autorizuar për mallra me akcizë të depoistit të autorizuar të mallrave me akcizë ose në objektet e autorizuara të ndonjë tregtari të autorizuar të mallrave me akcizë dhe të ndalojë a të konfiskojë ndonjë produkt me akcizë në bazë të marrëveshjes për pezullim që gjindet në këto objekte,

(b) autorizojë ndonjë zyrtar që të hyjë gjatë orarit të punës në ndonjë depo të autorizuar për mallra me akcizë të depoistit të autorizuar të mallrave me akcizë ose në objektet e autorizuara të ndonjë tregtari të autorizuar të mallrave me akcizë dhe të ndalojë e të konfiskojë ndonjë pasuri që i takon këtyre personave, duke i përfshirë automjetet dhe

(c) parandalojë depoistin e autorizuar të mallrave me akcizë ose tregtarin e autorizuar të mallrave me akcizë që të tregtojë me anë të ndonjë llogarie bankare afariste në emrin e tyre apo në emër të biznesit të tyre.

11.2 Asnjë mall nuk mund të ndalohet dhe të konfiskohet në bazë të këtij neni nëse vlera e mallrave të tjera të ndaluara dhe të konfiskuara për të përmbushur shumën e borxhit të akcizës e tejkalon shumën e këtij borxhi.

- 11.3 Drejtori i përgjithshëm mund të ushtrojë kompetencat që i janë dhënë atij në bazë të nenit 11.1(c) duke e njoftuar bankën në të cilën mbahet llogaria lidhur me borxhin për akcizën dhe se pa lejen me shkrim të drejtorit të përgjithshëm pronari nuk mund të tregtojë me këtë llogari.

KAPITULLI 3 AUTORIZIMET DHE MIRATIMET

Neni 12

Depot e autorizuar për mallrat me akcizë

12.1 Drejtori i përgjithshëm i autorizon lokalet që do të shfrytëzohen për prodhimin, përpunimin, mbajtjen, pranimin ose dërgimin e prodhimeve me akcizë sipas marrëveshjes për pezullim (“depot e autorizuar për mallrat me akcizë”), në rastet kur ai është i kënaqur që cilado vlerë e akcizës që do të vlejë për atë prodhim, përpunim, mbajtje, pranim ose dërgim do të ruhet.

12.2 Në kërkesën që i drejtohet drejtorit të përgjithshëm për të marrë autorizim për shfrytëzimin e lokaleve sipas nenit 12.1 përfshihen informatat vijuese:

- (a) përshkrimi ose harta që tregon saktësisht ku gjenden ato lokale;
- (b) përshkrimi ose plani i lokaleve që tregon saktësisht nëse vetëm një pjesë e atyre lokaleve do të shfrytëzohet për prodhimin, përpunimin, mbajtjen, pranimin ose dërgimin e prodhimeve me akcizë sipas marrëveshjes për pezullim, në rastet kur ato prodhime do të prodhohen, përpunohen, mbahen, pranohen apo dërgohen;
- (c) përshkrimi i masave të vendosura apo që do të vendosen për ta garantuar sigurinë e prodhimeve me akcizë dhe
- (d) përshkrimi lidhur me emërtimin dhe përshkrimin e tarifave, të prodhimeve me akcizë që sipas marrëveshjes për pezullim do të prodhohen, përpunohen, mbahen, pranohen ose dërgohen në lokale, dhe shuma normale e maksimale e atyre prodhimeve;

12.3 Çdo autorizim nga drejtori i përgjithshëm sipas nenit 12.1 mund t’i nënshtrohet kushteve të tilla, të cilat ai i konsideron të përshatshme t’i caktojë për të siguruar që çdo akcizë që duhet paguar të ruhet dhe e përfshin kushtin që depoisti i autorizuar për mallrat me akcizë të emërohet në lidhje me atë depo të autorizuar për mallrat me akcizë.

Neni 13

Depoisti i autorizuar për mallrat me akcizë

13.1 Drejtori i përgjithshëm e autorizon një person që të jetë depoist i autorizuar për mallrat me akcizë në ndonjë depo të autorizuar për mallrat me akcizë në rastet kur ai është i kënaqur që ai person është i përshtatshëm për t'u siguruar që çdo akcizë që duhet paguar për ndonjë prodhim me akcizë i cili prodhohet, përpunohet, mbahet ose dërgohet në atë depo të autorizuar për mallrat me akcizë sipas marrëveshjes për pezullim do të ruhet.

13.2 Në kërkesën që i bëhet drejtorit të përgjithshëm në mënyrë që një person të jetë depoist i autorizuar për mallrat me akcizë rreth cilëndo depoje të autorizuar për mallrat me akcizë sipas nenit 13.1 jepen informatat në vijim lidhur me atë person, si:

- (a) emri dhe adresa;
- (b) hollësitë për xhirollogarinë bankare;
- (c) gjendja financiare;
- (d) e kaluara personale dhe tatimore;
- (e) të dhënat që duhet të miratohen sipas nenit 15.1.

13.3 Çdo autorizim i lëshuar nga drejtori i përgjithshëm sipas nenit 13.1 mund t'i nënshtrohet kushteve të tilla që ai i sheh të përshtatshme për t'i caktuar në mënyrë që të sigurojë ruajtjen e çdo akcize që duhet paguar për ndonjë prodhim me akcizë i cili mbahet në një depo të autorizuar për mallrat me akcizë sipas marrëveshjes për pezullim për të cilin emërohet depoisti i autorizuar për mallrat me akcizë.

13.4 Nga depoisti i autorizuar për mallrat me akcizë në lidhje me çdo depo të autorizuar për mallrat me akcizë në rastet kur ai është depoist i autorizuar për mallrat me akcizë kërkohet t'i kryejë gjërat në vijim:

- (a) të ofrojë garanci të pranueshme, nëse është e nevojshme, për mbulimin e prodhimit, përpunimit, mbajtjes dhe pranimit dhe një garanci të pranueshme të detyrueshme për ta mbuluar dërgimin e prodhimeve me akcizë nga depoja e autorizuar për mallrat me akcizë;
- (b) të veprojë në pajtim me kushtet ligjore të parashtruara me ligjet e Kosovës;
- (c) t'i mbajë shënimet e kërkuara në nenin 15.1;
- (d) t'i paraqesë prodhimet me akcizë kurdo që këtë ia kërkon ndonjë zyrtar dhe
- (e) të pajtohet që zyrtarët të bëjnë kontrollime dhe verifikime.

13.5 Kur një prodhim me akcizë humb ose shkatërrohet për shkak të ndonjë fatkeqësie a force madhore në ndonjë depo të autorizuar për mallrat me akcizë, ose kur humbja ndodh gjatë lëvizjes deri në depon e autorizuar për mallrat me akcizë apo prej asaj që është pasojë

e lëvizjes së atij prodhimi të caktuar me akcizë, çdo person që ofron garanci lidhur me atë prodhim e njofton menjëherë drejtorin e përgjithshëm lidhur me atë humbje apo shkatërrim.

13.6 Kur drejtori i përgjithshëm sigurohet që humbja e prodhimeve me akcizë në një depo të autorizuar për mallrat me akcizë ose gjatë transportimit deri në depon e autorizuar për mallrat me akcizë apo prej asaj depeje për të cilën nga depoisti i autorizuar për mallra me akcizë është kërkuar të ofrojë garanci nuk është shkaktuar nga ndonjë aksident ose forcë madhore ose nuk ka qenë humbje si pasojë e llojit të prodhimeve me akcizë të cilat janë transportuar, prodhuar, përpunuar, mbajtur, pranuar ose dërguar, akciza konsiderohet se mund t'iu ngarkohet prodhimeve të humbura me akcizë sipas shkallës që do t'u ngarkoheshte në datën e humbjes ose, po qe se kjo nuk mund të përcaktohet, në datën e zbulimit të humbjes dhe paguhet nga depoisti i autorizuar për mallrat me akcizë.

Neni 14

Tregtari i autorizuar për mallrat me akcizë

14.1 Drejtori i përgjithshëm e autorizon një person të jetë tregtar i autorizuar për mallrat me akcizë në rastet kur është i sigurt që ai person ka nevojë biznesi për prodhimet me akcizë që do të shfrytëzohen për një qëllim që nuk i nështrohet akcizës.

14.2 Autorizimi sipas këtij neni kufizohet në një grup të caktuar të lokaleve, në një lloj të posaçëm të prodhimit me akcizë dhe në sasinë që mund të merret për një vit dhe mund ta kërkojë ofrimin e një garancie të kënaqshme për ta mbuluar shumën e akcizës të pezulluar në cilindo prodhim me akcizë në ato lokale.

14.3 Në kërkesën që i drejtohet drejtorit të përgjithshëm në mënyrë që një person të bëhet tregtar i autorizuar i mallrave me akcizë sipas nenit 14.1 përfshihen informatat në vijim lidhur me atë person:

- (a) emri dhe adresa;
- (b) hollësitë lidhur me xhirollogarinë bankare;
- (c) gjendja financiare;
- (d) e kaluara personale dhe tatimore;
- (e) godinat në të cilat pranohen këto prodhime me akcizë;
- (f) lloji i prodhimit me akcizë që pranohet;
- (g) sasia e prodhimit me akcizë që pranohet për një vit;
- (h) përdorimi i caktuar i atij prodhimi me akcizë dhe

- (i) shënimet që nevojiten të miratohen sipas nenit 15.2.

14.4 Nga tregtari i autorizuar për mallrat me akcizë kërkohet:

- (a) të veprojë në përputhje me kërkesat ligjore të parashtruara me ligjet e Kosovës;
- (b) t'i mbajë shënimet që kërkohen në nenin 15.2;
- (c) t'i tregojë prodhimet me akcizë kurdo që këtë e kërkon zyrtari dhe
- (d) të pajtohet për kontrollimin dhe verifikimin që e bëjnë zyrtarët.

14.5 Në rastet kur një prodhim me akcizë humb ose shkatërrohet për shkak të ndonjë fatkeqësie ose force madhore në lokalet e tregtarit të autorizuar për mallrat me akcizë ose në rastet kur humbja ndodh gjatë transportimit të tregtari i autorizuar për mallrat me akcizë, si pasojë e transportimit të atij prodhimi të caktuar me akcizë tregëtari i autorizuar për mallra me akcizë e njofton menjëherë drejtorin e përgjithshëm lidhur me atë humbje apo shkatërrim.

14.6 Në rastet kur drejtori i përgjithshëm sigurohet që humbja e prodhimit me akcizë në lokalet e tregtarit të autorizuar për mallra me akcizë ose gjatë transportimit deri te tregtari i autorizuar për mallrat me akcizë për të cilin nga tregtari i autorizuar për mallra me akcizë është kërkuar të ofrojë garanci, nuk është shkaktuar nga ndonjë aksident ose forcë madhore ose nuk ka qenë humbje si pasojë e llojit të prodhimeve me akcizë të cilat janë transportuar, konsiderohet që akciza mund t'iu ngarkohet prodhimeve të humbura me akcizë sipas shkallës që do ta ngarkonte në datën e humbjes ose, po qe se kjo nuk mund të përcaktohet, në datën e zbulimit të humbjes dhe paguhet nga tregtari i autorizuar për mallrat me akcizë.

Neni 15

Miratimi i regjistrave

15.1 Përveç rasteve kur ai konsideron se ato nuk janë të mjaftueshme për të siguruar që akciza që duhet paguar ruhet, drejtori i përgjithshëm i miraton regjistrat komercialë të cilitdo depoisti të autorizuar për mallrat me akcizë si regjistra që duhet të mbahen për prodhimet me akcizë që prodhohen, përpunohen, mbahen, pranohen apo dërgohen sipas marrëveshjes për pezullim në depon e autorizuar për mallrat me akcizë për të cilën është emëruar depoisti i autorizuar për mallra me akcizë.

15.2 Përveç në rastet kur ai konsideron se regjistrat komercialë janë të pamjaftueshëm për të siguruar që akciza që duhet paguar ruhet, drejtori i përgjithshëm i miraton ato të cilitdo tregtari të autorizuar për mallra me akcizë si regjistra që do të mbahen për prodhimet me akcizë të pranuar nga ai sipas marrëveshjes për pezullim.

15.3 Në rastet kur konsideron se është e domosdoshme të ruhet akciza që duhet të paguhet, drejtori i përgjithshëm mund të kërkojë që shënimet të mbahen në llojin e posaçëm të regjistrat, me faqe në të cilat gjenden numrat dhe faqet e të cilit nuk hiqen, të nënshkruar ose të vulosur nga shërbimi doganor i UNMIK-ut para se të përdoret ose në formë elektronike, në mënyrën që garanton se shënimet nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

15.4 Në kërkesën që i dërgohet drejtorit të përgjithshëm për t'i miratuar regjistrat sipas nenit 15.1 ose 15.2 përfshihen kopjet e regjistrave që janë mbajtur apo që duhet të mbahen së bashku me shembujt e regjistrave të plotësuar, dhe përfshihen shënimet:

- (a) lidhur me depon e autorizuar për mallrat me akcizë:
 - (i) vlerësimet e të ardhurave ose të prodhimit apo të përpunimit;
 - (ii) shënimet për stoqet që do të mbahen për lëndën e parë;
 - (iii) shënimet për stoqet që do të mbahen për prodhimet që janë duke u prodhuar apo përpunuar;
 - (iv) shënimet për stoqet që do të mbahen për prodhimet e përfunduara dhe
 - (v) shënimet që do të mbahen për të gjitha transportimet e stoqeve dhe të prodhimeve;
- dhe

(b) në lidhje me tregtarin e autorizuar për mallra me akcizë, shënimet e të gjitha stoqeve të prodhimeve me akcizë që janë pranuar dhe që pritet të pranohen.

15.5 Çdo miratim nga ana e drejtorit të përgjithshëm sipas nenit 15.1 ose 15.2 mund t'iu nënshtrohet kushteve të cilat ai i sheh të përshtatshme për t'i caktuar në mënyrë që të sigurohet ruajtja e akcizës e cila duhet paguar.

15.6 Nëse ndonjë depoist i autorizuar për mallrat me akcizë ose tregëtar i autorizuar për mallrat me akcizë nuk vepron në përputhje me kushtin e caktuar sipas nenit 15.5, drejtori i përgjithshëm mund t'i shqiptojë atij ndëshkim administrativ ndërmjet 500 dhe 10.000 eurove dhe, përveç kësaj, ndëshkim tjetër administrativ ndërmjet 10 dhe 100 eurove për çdo ditë që ai nuk vepron në përputhje me kushtet.

Neni 16

Refuzimi, revokimi dhe pezullimi i autorizimeve dhe miratimeve

16.1 Në rastet kur ai e konsideron të domosdoshme të veprojë ashtu për ta ruajtur akcizën që paguhet apo duhet paguar, drejtori i përgjithshëm mund ta refuzojë kërkesën për autorizim, miratim ose leje që kërkohet sipas këtij neni dhe ta revokojë ose pezullojë autorizimin, miratimin apo lejen e dhënë.

16.2 Çdo refuzim, revokim apo pezullim sipas nenit 16.1 është çështje për të cilën mund të ushtrohet ankesë në Bordin e pavarur për shqyrtim.

KAPITULLI 4 KOMPETENCAT

Neni 17

Dispozitat e përgjithshme

Asnjë kompetencë në këtë kapitull nuk e paraqet ndonjë çështje të pranueshme si dëshmi në procedurë penale e cila nuk do të ishte e pranueshme sipas Kodit të Përkohshëm për Procedurë Penale në Kosovë, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/26 e datës 6 korrik 2003.

Neni 18

Kompetenca për ta kërkuar paraqitjen e regjistrave të miratuar

18.1 Secili zyrtar mundet në çdo kohë të kërkojë që atij t'i paraqitet regjistri i miratuar sipas nenit 15.1 apo 15.2 ose i cili kërkohet të mbahet në mënyrë të caktuar sipas nenit 15.3.

18.2 Secili zyrtar mund të bëjë kopje të regjistrit apo të nxjerrë ekstrakte nga regjistrat që i paraqiten atij sipas nenit 18.1.

18.3 Nëse ai mendon që është e nevojshme të veprojë ashtu, zyrtari mundet në kohë të arsyeshme dhe për një periudhë të arsyeshme ta mënjanojë ndonjë regjistër të paraqitur sipas nenit 18.1 dhe në bazë të kërkesës ofron vërtetim për ndonjë regjistër të mënjeluar.

18.4 Në rastet kur çdo regjistër i mënjeluar nga një zyrtar sipas nenit 18.3 kërkohet në mënyrë të arsyeshme për kryerjen e punës, zyrtari, sa më parë që të jetë e mundur, ia jep një kopje të regjistrit pa pagesë personit që e ka paraqitur atë apo që ka ndikuar në paraqitjen e tij.

18.5 Çdo regjistër i mënjeluar nga zyrtari sipas nenit 18.3 kthehet në mënyrë të arsyeshme posa që të jetë mundur e dhe ai duhet të kthehet menjëherë në rastet kur nuk ekziston më arsyeja për mbajtjen e tij.

18.6 Në rastet kur çdo regjistër i mënjeluar nga zyrtari sipas nenit 18.3 humb ose dëmtohet, drejtori i përgjithshëm është i detyruar t'ia kompensojë pronarit të tij shpenzimet

që janë bërë në mënyrë të arsyeshme nga pronari për ta zëvendësuar apo rregulluar atë regjistër.

18.7 Në rastet kur në bazë të nenit 18.1 zyrtari ka kompetenca ta kërkojë paraqitjen e ndonjë regjistri:

(a) ai ka kompetenca të ngjashme ta kërkojë paraqitjen e regjistrit në fjalë nga cilido person tjetër, i cili i duket zyrtarit që e ka në posedim regjistrin, por

(b) nëse personi tjetër kërkon garanci për ndonjë regjistër të paraqitur nga ai, paraqitja bëhet pa e cenuar garancinë.

18.8 Nëse ndonjë person, në rastet kur nga ai kërkohet t'i paraqesë regjistrat sipas nenit 18.1 nuk vepron në pajtim me atë kërkesë, drejtori i përgjithshëm mund t'ia shqiptojë atij ndëshkimin administrativ ndërmjet 500 dhe 10.000 eurove, përveç ndëshkimit tjetër administrativ ndërmjet 10 dhe 100 eurove për secilën ditë që ai nuk vepron në pajtim me kërkesën.

Neni 19

Kompetenca për të hyrë dhe për të kontrolluar depon e autorizuar për mallra me akcizë

19.1 Cilido zyrtar që vepron në kuadër të fushëveprimit të kompetencave dhe të detyrave të tij në çdo kohë mund të hyjë në ndonjë depo të autorizuar për mallrat me akcizë dhe në lokalet e autorizuara të ndonjë tregtari të autorizuar për mallrat me akcizë dhe mund ta kontrollojë atë depo e ato lokale dhe të kërkojë, të kontrollojë e të marrë parasysh ndonjë makineri, automjet, enë, mjet, prodhim apo material që i përket apo në ndonjë mënyrë është i lidhur me atë depo ose me ato lokale.

19.2 Në rastet kur zyrtari ka kompetenca ta kontrollojë ndonjë depo ose lokal sipas nenit 19.1, atëherë, nëse pasi të ketë kërkuar ta pranojnë të hyjë në atë depo ose në ato lokale dhe pasi ta ketë deklaruar emrin dhe punën e tij në hyrje, nuk e pranojnë menjëherë, ai mund të thyejë ndonjë derë apo dritare të asaj depoje a të atyre lokaleve për të hyrë brenda ose të depërtojë nëpër ndonjë mur të tyre sipas nevojës me qëllim që të hyjë brenda.

19.3 Neni 19.1 zbatohet për ndonjë automjet apo ndërtesë në të cilën apo nga e cila shiten me pakicë prodhimet me akcizë ose në të cilën tregtohen ato ashtu siç zbatohet për depon e autorizuar për mallrat me akcizë dhe për lokalet e autorizuara të tregtarit të autorizuar për mallra me akcizë.

Neni 20

Kompetenca për ta siguruar urdhrin për kontrollimin e lokaleve

20.1 Në rastet kur gjykatësi është i kënaqur në bazë të kërkesës së zyrtarit që ka baza të arsyeshme për të dyshuar që:

(a) ndonjë vepër penale sipas nenit 28 është duke u kryer, është kryer apo do të kryhet në ndonjërin prej lokaleve ose që dëshmitë për kryerjen e veprës së tillë do të gjenden aty ose

(b) gjithçka që mund të ndalohet dhe konfiskohet mbahet ose fshihet në ndonjërin prej lokaleve,

ai mund ta nxjerrë një urdhër në formë të shkruar me të cilin e autorizon, në varësi të nenit 20.3 dhe 20.4, ndonjë zyrtar të hyjë në ato lokale nëse është e nevojshme me forcë në çdo kohë brenda tre muajve duke filluar prej datës së nxjerrjes së urdhrin dhe t'i kontrollojë ato.

20.2 Cilido zyrtar që hyn në lokale në bazë të autorizimit të urdhrin të nxjerrë sipas nenit 20.1 mund:

(a) t'i marrë me vete personat e tjerë të cilët i duken atij të nevojshëm;

(b) të konfiskojë dhe të largojë çdo gjë që gjendet në ato lokale për të cilat ai ka arsye të besojë që mund të ndalohen dhe të konfiskohen;

(c) të konfiskojë dhe të largojë dokumente ose gjëra të tjera çfarëdo qofshin ato të cilat gjenden në lokale e të cilat ai ka arsye të besojë se mund të nevojiten si dëshmi për ndonjë vepër penale sipas nenit 28;

(d) të konfiskojë dhe të largojë dokumente ose gjëra të tjera çfarëdo qofshin ato të cilat gjenden në lokale për të cilat ai ka arsye të besojë se mund të jenë dëshmi për ndonjë artikulli që mund të ndalohet ose të konfiskohet dhe

(e) të kontrollojë apo të bëjë që të kontrollohet ndonjë person që gjendet në lokale për të cilin ai ka arsye të besojë që ka dokumente ose artikuj të tillë, me kusht që në bazë të këtij nënparagrafi asnjë person nuk kontrollohet nga të tjerët përveç nga personi i gjinisë së njëjtë.

20.3 Kompetencat e dhëna me urdhër sipas këtij neni nuk ushtrohen:

(a) nga më shumë se një numër i tillë i zyrtarëve që saktësohet në urdhër as

(b) në kohë tjetër prej asaj që mund të saktësohet.

20.4 Zyrtari që kërkon t'i ushtrojë kompetencat e dhëna me urdhrin e nxjerrë sipas nenit 20.1 ose, nëse ekziston më shumë se një zyrtar i tillë, njëri nga ata që është përgjegjës për kontrollim e ofron një kopje të urdhrin të miratuar me emrin e tij si në vijim:

(a) nëse shfrytëzuesi i lokaleve në fjalë është i pranishëm në kohën kur do të fillojë kontrollimi, kopja i jepet shfrytëzuesit;

(b) nëse në atë kohë shfrytëzuesi nuk është i pranishëm, por është personi i cili i duket zyrtarit që është përgjegjës për lokalet, kopja i jepet atij personi dhe

(c) nëse nuk zbatohet as neni 20.4 (a) e as neni 20.4 (b), kopja lihet në një vend të dukshëm në lokal.

20.5 Kur për ndonjë arsye, në çfarëdo kohe ditën apo natën, nuk është e mundur të bisedohet me gjykatësin lidhur me sigurimin e urdhrin sipas këtij neni, drejtori i përgjithshëm apo ndonjë drejtor i Shërbimit Doganor mund ta autorizojë me shkrim ndonjë zyrtar i cili ka arsye të dyshojë që është plotësuar ndonjë prej arsyeve të parashtruara në nenin 20.1(a) ose 20.2(b) dhe të hyjë në lokalet në fjalë, nëse është e nevojshme me forcë, dhe të kontrollojë, ndalojë, konfiskojë a mënjanojë çdo gjë që i nënshtrohet ndalimit dhe konfiskimit ose që është dëshmi për vepër penale sipas nenit 28 apo për parandalimin e kryerjes së veprës së tillë.

20.6 Çdo zyrtar që ushtron ndonjë kompetencë sipas këtij neni i zbaton në mënyrë të përshtatshme dispozitat e kodit të procedurës penale në fuqi lidhur me kontrollimin dhe konfiskimin e përkohshëm deri në atë masë që nuk janë të papajtueshme me dispozitat e këtij neni.

Neni 21

Kompetencat për të marrë mostra

21.1 Çdo zyrtar në çdo kohë mund të marrë mostra të ndonjë prodhimi apo materiali:

(a) për të cilin e autorizon rregullorja ta kontrollojë;

(b) i cili gjendet në depon e autorizuar për mallrat me akcizë ose

(c) i cili, duke qenë prodhim me akcizë që i nënshtrohet marrëveshjes për pezullim, mbahet nga tregtari i autorizuar për mallra me akcizë.

21.2 Në rastet kur zyrtari merr nga ndonjë enë, tubë apo mjet mostër të ndonjë prodhimi apo materiali dhe e dërgon në depon e autorizuar për mallra me akcizë ose në lokalet e tregtarit të autorizuar për mallra me akcizë:

(a) personi që është përgjegjës për atë depo apo për ato lokale nëse dëshiron mund ta trazojë dhe përziej përmbajtjen e asaj ene, tube apo mjete para se të merret mostra dhe

(b) mostra të cilën e merr zyrtari konsiderohet të jetë shembull tipik i tërë përmbajtjes së asaj ene, tube apo mjete.

21.3 Çdo mostër e marrë sipas nenit 21.1 hudhet apo konsiderohet ashtu siç udhëzon drejtori i përgjithshëm me anë të një udhëzimi administrativ pas këshillimeve me Qeverinë.

21.4 Në rastet kur merret ndonjë mostër sipas nenit 21.1 nga ndonjë prodhim i ngarkuar me akcizë pasi që të paguhet ajo taksë, përveç mostrës së marrë nga prodhimi për të cilën është duke u bërë ndonjë kërkesë për zbritje, falje apo shlyerje të asaj takse dhe mostra e marrë në atë mënyrë nuk kthehet, zyrtari që e merr atë e paguan për mostrën një shumë të arsyeshme që e paraqet vlerën e shitjes me shumicë të asaj mostreje në emër të drejtorit të përgjithshëm, nëse këtë e kërkon personi që i posedon prodhimet.

Neni 22

Kompetenca për të hyrë në tokën për të pasur qasje në tubacionet apo lidhur me to

Në rastet kur një prodhim me akcizë që i nënshtrohet marrëveshjes për pezullim bartet me tubacione, çdo zyrtar mund të hyjë në tokën afër atij tubacioni në mënyrë që të arrijë te tubacioni me qëllim që ta ushtrojë kompetencën e dhënë për atë prodhim me akcizë me apo sipas kësaj Rregulloreje ose për të dalë nga tubacioni pas ushtrimit të kompetencës së tillë.

Neni 23

Kompetenca për të gjurmuar për tubacione të fshehura

23.1 Nëse ndonjë zyrtar ka arsye të fuqishme të dyshojë që ndonjë tubacion i fshehtë apo ndonjë mjet tjetër për bartje, rubinet, tubë apo enë është duke u përdorë në një depo të autorizuar për mallra me akcizë ose në lokalet e tregtarit të autorizuar për mallra me akcizë, ai zyrtar në çdo kohë mund ta thyejë cilëndo pjesë të asaj depoje ose të atyre lokaleve dhe të hyjë me forcë aty dhe aq sa është e domosdoshme në mënyrë të arsyeshme ta shkërmoqë dheun në atë depo apo afër asaj depoje ose të atyre lokaleve a ndonjë mur të tij për ta gjurmuar atë tubë ose mjetet tjera bartëse, rubinetin, tubën apo enën.

23.2 Nëse zyrtari gjen ndonjë tubë apo ndonjë formë tjetër të bartjes që çon në depon e autorizuar për mallrat me akcizë ose në lokalet e tregtarit të autorizuar për mallrat me akcizë a jashtë depos apo lokaleve, ai mund të hyjë në lokalet nga të cilat del ajo apo ku shpie ajo dhe për aq sa është e nevojshme e thyen në mënyrë të arsyeshme cilëndo pjesë të atyre lokaleve për ta zbuluar rrugën e tij dhe mund ta presë atë e ta rrotullojë rubinetin mbi atë dhe të kontrollojë nëse ai bart ose fshehë prodhime me akcizë ose ndonjë material që përdoret për prodhimin a përpunimin e prodhimeve me akcizë.

23.3 Çdo tubë apo ndonjë mjet tjetër bartës, rubinet, enë ose mjet i gjetur si rezultat i gjurmimit sipas nenit 23.1 ose 23.2 dhe çdo prodhim me akcizë që i nënshtrohet akcizës, ose çdo material për prodhimin dhe përpunimin e prodhimeve të tilla i gjetur aty i nënshtrohet ndalimit dhe konfiskimit.

23.4 Nëse shkaktohet ndonjë dëm gjatë gjurmimit sipas këtij neni dhe gjurmimi është i pasuksesshëm, drejtori i përgjithshëm e vërteton dëmin.

Neni 24
Kompetenca për të kontrolluar automjetet

24.1 Në rastet kur:

(a) automjeti gjendet në depon e autorizuar për mallrat me akcizë ose në lokalet e tregtarit të autorizuar për mallra me akcizë apo sapo ka dalë nga aty ose

(b) në ndonjë vend tjetër, ka arsye të fuqishme për të dyshuar që ai automjet është duke bartur një prodhim me akcizë i cili i nënshtrohet akcizës që nuk është paguar;

zyrtari mund ta ndalë atë automjet dhe ta kontrollojë atë.

24.2 Në rastet kur një automjet ndalet dhe kontrollohet sipas nenit 24.1, zyrtari ia tregon dokumentin e tij të identifikimit personit përgjegjës për atë automjet.

24.3 Kur kjo kërkohet nga ndonjë zyrtar i tillë, personi përgjegjës për ndonjë automjet refuzon të ndalet ose ta lejojë kontrollimin e tij, drejtori i përgjithshëm mund t'ia shqiptojë atij ndëshkimin administrativ ndërmjet 500 dhe 10.000 eurove dhe automjeti i nënshtrohet ndalimit dhe konfiskimit.

24.4 Prodhimet me akcizë të ngarkuara me akcizë të papaguar, të cilat gjenden të fshehura në ndonjë automjet si rezultat i kontrollimit, i nënshtrohen ndalimit dhe konfiskimit.

24.5 Automjeti, i cili, si rezultat i kontrollimit, zbulohet se është përshtatur për fshehjen e prodhimeve me akcizë të ngarkuara me akcizë e cila nuk është paguar, i nënshtrohet ndalimit dhe konfiskimit.

Neni 25
Kompetencat për të kontrolluar persona

25.1 Në rastet kur:

(a) personi gjendet brenda apo sapo ka dalë nga depoja e autorizuar për mallra me akcizë; ose

(b) në ndonjë vend tjetër, ekziston dyshim i bazuar që personi është duke bartë prodhim me akcizë, i cili është ngarkuar me akcizë e cila nuk është paguar;

zyrtari mund ta ndalë atë person dhe të kërkojë nga ai, në varësi të nenit 25.2 dhe 25.3, t'i nënshtrohet kontrollimit, por asnjë kërkesë e tillë nuk mund të realizohet nëse zyrtari nuk ia tregon dokumentin e identifikimit personit dhe pa e informuar personin për të drejtat e tij sipas nenit 25.2 dhe 25.3.

25.2 Nëse nga një person kërkohet që t'i nënshtrohet kontrollimit ai mund të kërkojë, dhe kjo nuk i mohohet, që të dalë para eprorit të zyrtarit në fjalë dhe eprori i merr parasysh arsyet e bazuara për dyshim dhe udhëzon në përputhje me rrethanat nëse nga personi kërkohet t'i nënshtrohet kontrollimit.

25.3 Kontrollimi i personit sipas nenit 25.1 kryhet vetëm nga personi i gjinisë së njëjtë.

25.4 Kontrollimi sipas nenit 25.1 nuk përfshin heqjen e teshave të veshura ose pranë lëkurës ose pranë rrobave të brendshme por mund ta përfshijë personin e prekur.

KAPITULLI 5 SHKELJET ADMINISTRATIVE DHE PENALE

Neni 26 Shkeljet administrative

26.1 Nëse ndonjë person:

(a) Nuk e përmbush cilindo kusht të paraparë nga drejtori i përgjithshëm sipas kësaj Rregulloreje;

(b) Bën apo nënshkruan ose ndikon që të bëhet a të nënshkruhet apo i dorëzon ose ndikon që t'i dorëzohet një nëpunësi çfarëdo deklarate, njoftim, certifikatë apo dokument tjetër ose jep deklaratë në përgjigje të çfarëdo pyetjeje që i parashtrohet nga nëpunësi në formë të dokumentit a të deklaratës të përpiluar apo të bërë për qëllime të akcizës, e cila është e pavartetë në çfarëdo aspekti material;

(c) Prodhon, importon, transporton, ofron për shitje apo shet, ekspozon, është në posedim të ndonjë produkti apo në çfarëdo mënyre tjetër ka të bëjë me produktin me akcizë dhe për të cilin nuk vlen marrëveshja për pezullim, si dhe për të cilin akciza vlen dhe nuk është paguar apo në çfarëdo mënyre tjetër është i përfshirë në mospagesën e akcizës për produktin që i nënshtrohet akcizës;

(d) Lejon që objektet nën kontrollin apo nën posedimin e tij të shfrytëzohen për shitjen apo për çfarëdo trajtimi tjetër të produktit me akcizë dhe për të cilin nuk vlen marrëveshja për pezullim, si dhe për të cilin akciza nuk është paguar në kohën e duhur apo

(e) Prodhon çfarëdo produkti me akcizë në objektet të cilat nuk janë të autorizuara sipas nenit 12 ose për të cilat nuk ekziston depo e autorizuar sipas nenit 13 për produkte me akcizë;

drejtori i përgjithshëm mund t'i shqiptojë atij një gjobë administrative prej 500 € deri në 10.000 € dhe çdo produkt a material që i nënshtrohet akcizës e lidhur me të cilin është bërë shkelja administrative, i nënshtrohet ndalimit apo konfiskimit.

26.2 Çdo gjobë administrative e shqiptuar sipas kësaj Rregulloreje konsiderohet si akcizë e pagueshme dhe mund të arkëtohet në përputhje me dispozitat e nenit 11 (c) sikurse personi në fjalë të ishte shitblerës i produkteve me akcizë dhe objektet të ishin objekte të autorizuar.

Neni 27 Shkeljet penale

Pa paragjykim në dispozitat në fuqi të Kodit Penal të Kosovës (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/25 e datës 6 korrik 2003):

(a) Nenet 87, 88, 91 dhe 92 të Kodit Doganor të Kosovës (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2004/1 e datës 30 janar 2004) vlejnë sipas kësaj Rregulloreje në rastet kur kemi të bëjmë me akcizë dhe

(b) Neni 6.5 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/23 të datës 25 qershor 2003 për akcizën në produktet e duhanit në Kosovë vlen sipas kësaj Rregulloreje për çfarëdo etikete fiskale të akcizës,

derisa të përfshihen dispozitat e kërkuara në Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës.

Neni 28 Zbatimi i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës

Kur zyrtari zbaton hetime ose zhvillon procedurë për shkeljen penale sipas nenit 27, ai konsiderohet si zyrtar i "policisë gjyqësore" sipas kapitullit XXIX të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/26 e datës 6 korrik 2003) dhe si zyrtar i "policisë" sipas kapitujve XIX, XX, XXIII dhe XXIV të atij Kodi.

KAPITULLI 6 **NDALIMI DHE KONFISKIMI**

Neni 29 Ndalimi dhe konfiskimi i produkteve me akcizë

29.1 Në rastin kur ndonjë produkt me akcizë i përmbush kushtet për ndalim apo konfiskim në bazë të cilitdo neni të kësaj Rregulloreje ose në bazë të kësaj Rregulloreje:

(a) Çdo automjet, shtazë, kontejner apo çfarëdo gjëje tjetër e cila është shfrytëzuar për bartje, trajtim, ruajtje apo fshehje të produktit me akcizë dhe

- (b) Çdo gjë tjetër e përzier, e paketuar apo e gjetur në produktin me akcizë

Gjithashtu i plotëson kushtet për ndalim a konfiskim dhe çdo referim në këtë nen në çfarëdo produkti me akcizë konsiderohet si referim në atë automjet, shtazë, kontejner apo në një gjë tjetër.

29.2 Në rastin kur cilitdo zyrtari, duke u mbështetur në cilëndo dispozitë ose sipas kësaj Rregulloreje, i duket se çfarëdo produkti me akcizë i plotëson kushtet për ndalim apo konfiskim sipas nenit 29.3, ai mund ta ndalojë atë produkt deri në 30 ditë prej datës së marrjes së tij, apo në rastet kur kjo kohë është më e shkurtër, derisa të nxirret vendimi nëse do t'i kthehet apo jo pronarit të tij apo cilitdo person që duket se është pronari i tij (më tutje në tekst "pronari"), pa parashtrimin e çfarëdo kushti.

29.3 Në rastin kur në rrethana të jashtëzakonshme të një rasti individual drejtori i përgjithshëm konsideron se periudha maksimale prej 30 ditësh e paraparë në nenin 29.2 është e pamjaftueshme për të mundësuar kryerjen e hetimeve të duhura, ai mund që para skadimit të atyre 30 ditëve të vazhdojë atë periudhë deri në 60 ditë të tjera, në të cilin rast ai do të:

(a) Njoftojë pronarin për vazhdimin sipas mënyrës së paraparë për njoftim në nenin 29.7 dhe

(b) Në të njëjtën kohë, t'ia shpjegojë pronarit arsyen pse ai mendon se ekzistojnë ato rrethana të jashtëzakonshme.

29.4 Në rastin kur çfarëdo produkti me akcizë është ndaluar por nuk është konfiskuar, drejtori i përgjithshëm mund t'ia kthejë pronarit sipas kushteve që ai mund t'i shqiptojë dhe pa paragjykuar çfarëdo të drejte që pronari mund ta ketë.

29.5 Në rastin kur pas kalimit të periudhës prej 30 ditëve të paraparë në nenin 29.2 ose të kalimit të periudhës së vazhduar deri në 90 ditë të paraparë në nenin 29.3 ende nuk është marrë vendimi për kthim apo jo të çfarëdo produkti me akcizë të ndaluar pronarit të tij pa parashtrimin e çfarëdo kushti, produkti me akcizë do të konsiderohet se është konfiskuar.

29.6 Në rastin kur:

(a) brenda kufizimeve kohore të parapara në nenet 29.2 ose në 29.3 nxirret vendimi për të mos ia kthyer pronarit çfarëdo produkti të marrë pa parashtrimin e çfarëdo kushti, zyrtari e konfiskon produktin në fjalë apo

(b) cilido produkt me akcizë konsiderohet të jetë konfiskuar sipas nenit 29.5, zyrtari e njofton pronarin për konfiskimin dhe për arsyet e tij sipas mënyrës së paraparë për njoftim në nenin 29.7.

29.7 Njoftimi sipas këtij neni bëhet me shkrim dhe:

(a) i jepet pronarit në dorë apo lihet a dërgohet me postë në adresën e fundit të ditur të pronarit;

(b) i jepet agjentit të pronarit në dorë apo i dërgohet me postë;

(c) në rastin kur pronari ka adresë elektronike i dërgohet në atë adresë dhe

(d) në rastin kur produkti me akcizë është ndalë apo konfiskuar në depon e autorizuar ose në objektet e shitblerësit të autorizuar të produkteve me akcizë, duke e lënë në atë depo apo në ato objekte.

29.8 Drejtori i përgjithshëm i mban të hapura për publik në selinë e Shërbimit Doganor të gjitha njoftimet aktuale për konfiskim dhe gjithashtu mban një kopje të njoftimit në versionin elektronik.

29.9 Në nenin 29.8 “njoftimet aktuale për konfiskim” do të thotë të gjitha njoftimet për konfiskim për të cilat ende nuk ka kaluar afati për kërkesë të shqyrtimit sipas nenit 30.1 dhe në rastin kur është dorëzuar kërkesa për shqyrtim, ndërsa çështja nuk është zgjidhur qoftë nga Bordi i pavarur për shqyrtime apo gjatë shqyrtimit të vendimit të Bordit të pavarur për shqyrtime nga gjykata kompetente ose për arsye të moskalimit qoftë të afatit të ankesës a të parashtrimit të kërkesës.

29.10 Në rastin kur çfarëdo produkti me akcizë konsiderohet si i konfiskuar sipas nenit 29.5 apo është konfiskuar sipas nenit 29.6 dhe

(a) Kur afati i kërkesës për shqyrtim nga drejtori i përgjithshëm sipas nenit 30.1 nuk ka kaluar ose kur kërkesa për shqyrtim është dorëzuar dhe çështja nuk është zgjidhur përfundimisht qoftë nga drejtori i përgjithshëm, nga Bordi i pavarur shqyrtues, nga gjykata kompetente apo për shkak të moskalimit qoftë të afatit të ankesës ose të parashtrimit të kërkesës, drejtori i përgjithshëm mund t’ia kthejë produktin me akcizë pronarit pas pagesës së shumës për të cilën vendos drejtori i përgjithshëm dhe që ai person ia paguan Shërbimin Doganor, e cila shumë nuk kalon vlerën e produktit me akcizë, duke përfshirë edhe çfarëdo akcize të pagueshme për të që nuk është paguar apo

(b) Në rastin kur afati i kërkesës për shqyrtim nga drejtori i përgjithshëm sipas nenit 30.1 ka kaluar dhe kur kërkesa për shqyrtim nuk është dorëzuar apo në rastin kur kërkesa për shqyrtim është dorëzuar dhe çështja është zgjidhur përfundimisht qoftë nga drejtori i përgjithshëm, nga Bordi i pavarur shqyrtues apo nga gjykata kompetente ose për shkak të kalimit të afatit për ankesë a të afatit për parashtrimin e kërkesës, drejtori i përgjithshëm mund:

(i) T’ia kthejë produktin me akcizë pronarit pasi që ai person të ketë paguar doganën në shumën për të cilën vendos drejtori i përgjithshëm, ku shumata e tillë nuk kalon vlerën e produktit me akcizë, duke përfshirë çfarëdo akcize të pagueshme e cila nuk është paguar dhe

(ii) Në çfarëdo kohe ta heqë atë duke e shitur apo duke e shkatërruar.

29.11 Në rastin kur çfarëdo produkti është shitur sipas autorizimit të paraparë në këtë nen, të hyrat nga shitja do të shkojnë në buxhetin e konsoliduar të Kosovës.

29.12 Neni 30 vlen për ankesat kundër çfarëdo gjëje të ndaluar apo të konfiskuar.

KAPITULLI ANKESAT

Neni 30 Ankesat

30.1 Në rastin kur drejtori i përgjithshëm apo cilido nëpunës merr vendimin:

(a) Që ndikon në çfarëdo shume të akcizës që personi duhet ta paguajë qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë;

(b) Që është vendim për shqiptimin e çfarëdo gjobeje administrative;

(c) Që është vendim për konfiskimin e çfarëdo gjëje që është ndaluar apo për zgjatjen e afatit kohor përkitazi me marrjen e vendimit lidhur me atë konfiskim;

(d) Që është kusht për kthim të çfarëdo gjëje të ndaluar apo të konfiskuar ose

(e) Që është vendim për të cilin jepet e drejta specifike për ankesë sipas neneve 8.4 dhe 16.2.

Atëherë cilido person i prekur nga ai vendim mund të kërkojë nga drejtori i përgjithshëm që ta shqyrtojë atë. Çfarëdo kërkesë për rishikim apo për shqyrtim nga drejtori i përgjithshëm bëhet brenda 60 ditëve nga marrja e vendimit duke e bërë njoftimin me shkrim të mbështetur me dëshmi të dokumentuara të cilat personi dëshiron t'i paraqet. Drejtori i përgjithshëm mund të zgjasë afatin ashtu siç e sheh të arsyeshme, në kuadër të së cilit kërkohet që të bëhet kërkesa për rishikim apo shqyrtim sipas këtij paragrafi.

30.2 Drejtori i përgjithshëm e njofton me shkrim personin i cili ka kërkuar rishikim apo shqyrtim të vendimit të tij për shqyrtim sipas nenit 30.1 brenda 60 ditëve nga data e marrjes së kërkesës. Në rastin kur drejtori i përgjithshëm nuk e njofton personin sipas mënyrës së kërkuar do të konsiderohet se drejtori i përgjithshëm ka vërtetuar vendimin.

30.3 Brenda 60 ditëve nga data kur drejtori i përgjithshëm ka bërë të njohur vendimin e tij lidhur me kërkesën për rishikim apo shqyrtim apo kur konsiderohet se ka vërtetuar vendimin e tij sipas nenit 30.2, personi që ka kërkuar rishikim apo shqyrtim mund t'i

parashtrojë ankesë Bordit të pavarur shqyrtues (më tutje në tekst “Bordi”). Ankesa i parashtrohet Bordit në formë të shkruar dhe mbështetet me dëshmi të dokumentuara, të cilat personi (më tutje në tekst “ankuesi”) dëshiron t’i paraqesë. Drejtori i përgjithshëm përgjigjet me shkrim ndaj ankesës brenda 30 ditësh nga data e njoftimit për ankesën.

30.4 Bordi mban një seancë dëgjimore lidhur me ankesën brenda 60 ditëve nga data e parashtrimit të ankesës. Gjatë seancës dëgjimore lidhur me ankesën, ankuesi mund t’i jep Bordit dëshmi me gojë apo me shkrim. Në rastin kur kjo ndodh, drejtori i përgjithshëm gjithashtu do ta ketë mundësinë të paraqesë dëshmi me gojë dhe me shkrim. Ankuesi ka obligimin për të dëshmuar se vendimi i drejtorit të përgjithshëm është i gabueshëm.

30.5 Brenda 30 ditëve nga data e përfundimit të seancës, Bordi njofton palët për vendimin e tij së bashku me arsyetimin me shkrim përkitazi me vendimin.

30.6 Ankuesi apo drejtori i përgjithshëm mund të parashtrojnë kërkesë në gjykatën kompetente për shqyrtim të vendimit të marrë nga Bordi.

30.7 Kërkesa për shqyrtim nga drejtori i përgjithshëm e bërë në pajtim me nenin 30.1, ankesa e parashtruar për Bordin sipas nenit 30.3 apo kërkesa për shqyrtim në gjykatë sipas nenit 30.5 nuk pezullon çfarëdo obligimi për pagesën e çfarëdo akcize të kontestuar, përpos që drejtori i përgjithshëm, Bordi apo gjykata pas parashtrimit të kërkesës mund të urdhërojnë që obligimi për pagesë të pezullohet derisa ata ta marrin vendimin e tyre.

30.8 Në rastin kur kontesti përfundimisht zgjidhet në dobi të:

(a) Drejtorit të përgjithshëm, tatimpaguesi paguan akcizën e mbetur borxh, gjobat dhe çfarëdo kamate të akumuluar deri në zgjidhjen e çështjes;

(b) Ankuesit dhe drejtorit të përgjithshëm;

(i) Kthejnë çfarëdo akcize të paguar së bashku me kamatën e saj të akumuluar deri në momentin e zgjidhjes së çështjes dhe

(ii) Në rastin kur çfarëdo produkti i është kthyer pronarit, është shitur apo është shkatërruar:

- Shumën a barabartë me çfarëdo shume të paguar nga pronari i tij për kthimin e produktit;
- Në rastin kur produkti është shitur, shumën e barabartë me të hyrat nga shitja ose
- Në rastin kur produkti është shkatërruar, shumën e barabartë me vlerën e tregut të produktit në kohën e konfiskimit të tij.

KAPITULLI 8
SHFUQIZIMET, LIGJI NË FUQI DHE HYRJA NË FUQI

Neni 31
Shfuqizimet

Me anë të këtij neni shfuqizohen rregulloret dhe urdhëresat administrative të paraqitura në shtojcën D të kësaj Rregulloreje.

Neni 32
Zbatimi

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të nxjerrë urdhëresa administrative për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 33
Ligji në fuqi

Kjo Rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi e cila nuk është në përputhje me këtë Rregullore.

Neni 34
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 1 korrik 2005.

Søren Jessen-Petersen
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

SHTOJCA A
MALLRAT QË I NËNSHTROHEN AKCIZAVE DHE TARIFAT PËRKATËSE

Përshkrimi i mallit	Shifra	Tarifa e taksës
Kafja e papjekur	0901 1100 0901 1200	30%
Kafja e pjekur	0901 2100 0901 2200	30%
Zëvendësimet e kafesë që përmbajnë kafe	0901 9090	30%
Ujërat, duke përfshirë ujërat minerale dhe të ajrizuara të cilat përmbajnë sheqer të shtuar a ndonjë materie tjetër ëmbëlsuese apo që janë me shije, si dhe pijet e tjera joalkoolike, duke mos përfshirë lëngjet e frutave apo të perimeve nga kaptina 2009.	2202	10%
Birra e prodhuar nga malti	2203	0,15 €/lit
Verërat nga rrushi i freskët, duke përfshirë verërat me përmbajtje të shtuar të alkoolit; mushti i rrushit, përpos atij nga kaptina 2009	2204	0,20 €/lit
Vermuti dhe verërat e tjera nga rrushi i freskët me shije të bimëve apo të substancave aromatike	2205	0,20 €/lit
Pijet e tjera të fermentuara (për shembull mushti i mollës apo i dardhës, pijet alkoolike nga fermentimi i mjaltës); përzierjet e pijeve të fermentuara dhe përzierjet e pijeve të fermentuara e të pijeve joalkoolike të cilat nuk janë cekur ose nuk janë përfshirë diku tjetër	2206	0,15 €/lit
Etil alkooli i padenaturizuar me përqindje të alkoolit prej 80% apo më të lartë; etil alkooli dhe pijet e tjera alkoolike të denaturizuara të cilësdo përqindje alkoolike	2407	1,00 €/lit alkool
Etil alkool i padenaturizuar me përqindje të alkoolit prej më pak se 80%; pijet alkoolike, likerët dhe pijet e tjera alkoolike	2208	1,00 €/lit alkool
Cigaret, cigaret e prera dhe cigarillosët të cilat përmbajnë duhan	2402 1000	1,00 € për një njësi

		konvencionale (1)
Cigaret që përmbajnë duhan	2402 20	17,00 € për një njësi konvencionale (1)
Prodhimet e tjera të përpunuara të duhanit dhe zëvendësimet e përpunuara të duhanit; duhani i "homegjenizuar" apo "i ribërë përmes përpunimit"; ekstraktet dhe esencat e duhanit	2403	17,00 € për një njësi konvencionale (1)
Vajrat dhe prodhimet e tjera të destilimit të katranit të thëngjillit në temperatura të larta; produktet e ngjashme në të cilët pesha e përbërësve aromatikë është më e madhe se e përbërësve joaromatikë	2707	0,275 €/lit
Vajrat e petroleumit dhe vajërat e përfituara nga mineralet bituminoze (përpos naftës së papërpunuar); produktet që nuk janë cekur apo përfshirë tjetërkund, të cilat përmbajnë në peshë 70% apo më shumë vajra të petroleumit apo vajra të përfituara nga mineralet bituminoze, ku këto vajra janë përberësit kryesorë të produktit (përpos vajrave të përdorura), me përjashtim të alkoolit për motorë, karburantit të llojit të alkoolit për motorë reaktivë dhe të vajrave të tjerë të lehtë (shifrat 2710 1131 deri 2710 1190) dhe vajrat për nxemje (mazuti) nën shifrat 2710 1951 deri 2710 1969 të cilat përdoren nga objektet për nxemje të qarkut për qëllime të nxemjes dhe nga personat e entitetet për qëllime të prodhimitarisë	2710 11 dhe 2710 19	0,275 €/lit
Alkooli për motorë, karburantet e llojit të alkoolit për motorët reaktivë dhe vajrat e tjera të lehta	2710 1131 deri 2710 1190	0,30 €/lit
Hidrokarburet aciklike	2901	0,275 €/lit
Hidrokarburet ciklike	2902	0,275 €/lit
Produktet kundërdetonuese, inhibitorët e oksidimit, inhibitorët e ngjitjes, përmirësuesit e viskozitetit, produktet antikorozive dhe aditivët e tjerë të prodhuar për vajrat minerale (duke përfshirë benzinën) apo për lëngjet e tjera të cilat përdoren për qëllime të njëjta si vajrat minerale	3811	0,275 €/lit
Tretësit kompozit organik dhe holluesit të cilët nuk janë cekur a përfshirë diku tjetër; holluesit e prodhuar të ngjyrës apo të llakut	3814	0,275 €/lit
Alkilbenzenët e përzier dhe alkilnaftalenët e përzier,	3817	0,275 €/lit

¹ Përkufizimi i "njësisë konvencionale" për këto pika gjendet në nenin 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/23 për akcizat në prodhimet e duhanit në Kosovë të datës 25 qershor 2003,

përpos atyre nga kaptina 2707 apo 2902		
Veturat dhe automjetet e tjera motorike parimisht të disenjuara për transport të personave (përpos atyre nga kaptina 8702), duke përfshirë veturat karavan dhe veturat për gara	8703	500 € për çdo automjet

SHTOJCA B
PRODUKTET E LIRUARA NGA AKCIZA

Akzica nuk vlen për:

(a) Lëndën e parë dhe lëndën ndihmëse e cila përndryshe do t'i nënshtrohej akcizës, të importuar në Kosovë nga personat e pajisur me licencë të lëshuar nga Shërbimi Doganor i UNMIK-ut, i cili autorizon importin e tillë në rastin kur lënda e tillë do të përdoret në prodhimin e mallrave për eksport;

(b) Mallrat për të cilat drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Doganor të UNMIK-ut përcakton se do të shfrytëzohen vetëm për qëllime humanitare dhe se nuk do të ofrohen për shitje a për konsumim në Kosovë dhe

(c) Mallrat e financuara nga të hyrat e granteve të dhëna për UNMIK-un nga qeveritë, agjencitë qeveritare, organizatat qeveritare apo joqeveritare në përkrahje të programeve humanitare dhe të rindërtimit, si dhe të projekteve në Kosovë.

SHTOJCA C
ORGANIZATAT DHE SUBJEKTET TJERA QË NUK PAGUAJNË AKCIZË

Akciza nuk paguhet nga:

- (a) Misionet e huaja diplomatike dhe konsulare;
- (b) Kombet e Bashkuara apo cilido organ i saj, duke përfshirë UNMIK-un, agjencitë e specializuara të Kombeve të Bashkuara, KFOR-in, organizatat ndërkombëtare ndërqeveritare dhe agjencitë qeveritare përkitazi me mallrat e përdorura për qëllime zyrtare;
- (c) Kontraktorët e UNMIK-ut, agjencitë e specializuara të Kombeve të Bashkuara dhe të KFOR-it të cilët importojnë mallra që do të përdoren nga ata kontraktorë vetëm përkitazi me përmbushjen e kontratave për UNMIK-un, agjencitë e specializuara të Kombeve të Bashkuara dhe për KFOR-in dhe
- (d) Organizatat e regjistruara joqeveritare me status të beneficuar publik siç parashihet me Rregulloren nr. 1999/22 të datës 15 nëntor 1999 për mallrat e përdorura vetëm nga organizatat joqeveritare në përmbushjen e qëllimeve të statusit të saj të beneficuar. Këto mallra janë si në vijim: benzina, kerozina, nafta dhe etanoli.

SHTOJCA D SHFUQIZIMET

Rregulloret:

1. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/2 për akcizën në Kosovë e datës 22 janar 2000.
2. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/26 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/2 për akcizën në Kosovë e datës 27 prill 2000.
3. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/35 për ndryshimin e Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2000/2 për akcizën në Kosovë e datës 16 qershor 2000.
4. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/56 për ndryshimin e Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2000/2 për akcizën në Kosovë e datës 6 tetor 2000.
5. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/15 për ndryshimin e Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2000/2 për akcizën në Kosovë e datës 3 korrik 2001.
6. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/38 për ndryshimin e Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut për akcizën në Kosovë e datës 31 dhjetor 2001.
7. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2002/16 për ndryshimin e Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2000/2 për akcizën në Kosovë e datës 1 gusht 2002.
8. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2004/27 për ndryshimin e Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2000/2 për akcizën në Kosovë e datës 29 korrik 2004.
9. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2005/10 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/2 mbi akcizat në Kosovë e datës 28 shkurt 2005.

Urdhëresat administrative:

1. Urdhëresa administrative nr. 2000/1 e datës 22 janar 2000 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/2 mbi akcizat në Kosovë të datës 22 janar 2000.
2. Urdhëresa administrative nr. 2000/19 e datës 21 gusht 2000 për ndryshimin e Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2000/1 mbi zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/2 për akcizën në Kosovë të datës 22 janar 2000.
3. Urdhëresa administrative nr. 2002/21 e datës 1 tetor 2002 për zbatimin e Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2000/2 mbi akcizën në Kosovë.